

Datës-kleznas

Nr. X-73
Br.

Data 18.02.2021
Datum

OBILIĆ-OBILIĆ



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Komuna e Obiliqit - Opština Obilić - Municipality Obiliq

Drejtoria e Arsimit

Bazuar në nenin 8, paragrafi 1 dhe 2, të Ligji i Punës, nr.03/L -212, neni 5, paragrafi c, Ligji për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, nr.03/L-068, neni 35, Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, nr.04/L-032, Udhëzimet Administrative , i MASHTI-it nr.5/2021, dhe i MPMS , nr. 07/2017 dhe kërkesën me nr. -X-67, e datës 16.02.2022, Drejtoria e Arsimit me datë 18.02.2022, shpall :

KONKURS

(Për plotësimin e vendeve të punës)

- SHFMU "Dr.Ibrahim Rugova " në Obiliq
Vendet e punës :Një mësues klase , zëvendësimit i pushimit të lehonisë
Një asistent për fëmijët ,nxënësit me nevoja të veçanta
Një asistent për fëmijët, nxënësit me nevoja të veçanta,lëvizës edhe në shkollat tjera
- SHFMU"Hasan Prishtina " në Milloshevë
Vendi i punës:Një asistent për fëmijët,nxënësit me nevoja të veçanta
- SHFMU"Naim Frashëri " në Breznicë
Vendi i punës : Një punëtor teknik

Kushtet për mësimdhënësit :

Kërkohet kualifikimi profesional përkatës, sipas Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Republikën e Kosovës dhe Udhëzimit Administrativ nga MASHTI, nr.5/2021.

Detyrat për asistent të fëmijëve, nxënësve me nevoja të veçanta arsimore.

- Ndhmon fëmijët/nxënësit në zhvillimin dhe promovimin e pavarësisë, orientim dhe mobilitet, transport, pozitën dhe uljen e nxënësit në klasë.
- Punon me mësimdhënësit dhe stafin tjetër për zbatimin e PIA-së, lëndët të individualizuara ose mësim në fusha të aktiviteteve.
- Përgatitë materiale mësimore si dhe menaxhon me pajisjet e nevojshme brenda dhe jashtë klasës.
- Vëzhgon dhe dokumenton vështirësitë dhe nevojat e identifikuar të fëmijëve, përgatitë informata kthyesë për vështirësitë dhe arritjet e fëmijëve.

- Promovon arsimin gjithëpërfshirës dhe pranimin e të gjithë fëmijëve në klasë, inkurajon fëmijët në komunikim, pjesëmarrje në lojë dhe stimulimin e të folurit dhe gjuhës përmes bisedës dhe lojës
- Mbikëqyrë dhe ndihmon fëmijët/nxënësit gjatë racioneve ushqimore, kujdeset për nevojat fizike/ personale, mjekësore dhe asiston në veshjen dhe pastërtinë e përgjithshme të tyre.
- Planifikon me mësuesin/mësuesit programin ditor dhe javor për mësim, aktivitete dhe ngjarje me qëllim të mbështetjes së fëmijëve për mësim.
- Promovon bashkëpunimin shkollë – shtëpi, mbështetë dhe diskuton çështje të ndjeshme me prindin/kujdestarin.
- Respekton rregullat dhe etikën e shkollës, sjelljet e mira ndaj nxënësve.
- Prezanton punën dhe arritjet e nxënësve.
- Informacionet në shkollë i trajtojnë si plotësisht konfidenciale.

Kualifikimi për asistentë për fëmijët, nxënësit me nevoja të veçanta:

Shkolla e Mesme dhe Niveli 5-të (Postsekondar) i kualifikimit asistent për fëmijë,nxënës me nevoja të veçanta arsimore.Kërkohet përgatitja adekuate profesionale sipas normativet të MASHT-it në fuqi.

Kualifikimi për punëtor teknik: shkolla e mesme e lartë(SHML)

Kandidatët që konkurojnë për mësime dhënë , punëtor teknik , dhe asistent për fëmijët,nxënësit me nevoja të veçanta duhet ta sjellin kopjen e diplomës së fakultetit të vërtetuar apo noterizuar ,vërtetimin për përvijën e punës, certifikatën e lindjes, dokumentin e letërnjoftimit.

Kandidatët,që konkurrojnë për këto vendet e punës, të cilët kanë diplomuar jashtë Republikës së Kosovës, të cilët nuk i kanë diplomat e nostifikuara në MASHT nuk do të përfshihen në listën e ngushtë.

Fletëkërkesat merren në Zyrën e Pranimin të KK-së, apo në faqen zyrtare të komunës dhe dorëzohen me dokumentet të kompletuara në të njëjtën zyrë.Kandidatët do të ftohen në intervistë përmes telefonit.

Afati i konkursit është 15 ditë nga dita e publikimit në shtyp dhe te faqja zyrtare e komunës.

Drejtori : Sahit Zeqiri

